

SHOQERIA "ALADINI TRADE PARTNER"SH.P.K

Njësia Bashkiake nr.11, Rruga e Durrësit, "Blloku Gintash", Laprake,
Ndërtesa 3 katëshe, nr.1, Dyqani nr.11
Tiranë-Albania

V E N D I M
I ASAMBLESE TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"ALADINI TRADE PARTNER"SH.P.K

Asambleja e ortakëve të Shoqërisë "Aladini Trade Partner"Sh.p.k. e mbledhur sot me datën 28.04.2021, me seli: Njësia Bashkiake nr.11, Rruga e Durrësit, "Blloku Gintash", Laprake, Ndërtesa 3 katëshe, nr.1, Dyqani nr.11, me numër NIPT: M02311002E, pasi mori në shqyrtim rendin e dites të caktuar nga administratori i saj Z.Spiro Naçi si më poshtë:

- Miratimi i marrjes së huasë nga Z.Vasil Naçi ne shumën prej 250.000 Euro.
- Miratimin e mostjetërsimit të 52% të kuotave të kapitalit të shoqërisë si garanci për kthimin e detyrimit të huasë.

K O N S T A T O I S E :

Z.Spiro Naçi,me cilësinë Administratorit të shoqërisë "Aladini Trade Partner"Sh.p.k., ka kërkuar në Asamblene e shoqërisë miratimin e marrjes së huasë nga z.Vasil Naçi ne shumën prej 250.000 Euro, si dhe mostjetërsimin të 52% të kuotave të kapitalit të shoqërisë si garanci për kthimin e detyrimit të huasë.

Në mbledhje morën pjesë ortakët e shoqërisë respektivisht:

Z. Spiro Naçi , që zotëron 75 % të kapitalit të shoqërisë, dhe me të drejtë vote të barabartë me % e zotërimit të kapitalit,

Z.Valer Pinderi, që zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë, dhe me të drejtë vote të barabartë me % e zotërimit të kapitalit,

Z.Gerti Boshnjaku, që zotëron 5% të kapitalit të shoqërisë, dhe me të drejtë vote të barabartë me % e zotërimit të kapitalit.

Ortakët e shoqërisë "Aladini Trade Partner"Sh.p.k. që zotërojnë 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Aladini Trade Partner"Sh.p.k. kanë të drejtë vote të barabarte me % e zotërimit të kapitalit të shoqërisë.

Në shqyrtimin, analizën e bëre nga ortakët e shoqërisë, Asambleja u shpreh se shoqëria për shkak të mungesës së mjeteve financiare (likuiditete) dhe për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë duhet të gjeje burime financimi. Një nga burimet e financimit është vlerësuar marrja e një huaje nga Z.Vasil Naçi në shumën prej 250.000 Euro. Afati i kthimit të huasë të jetë për një afat deri në 3 vjet dhe me një norme interesi jo me shumë se 3% me bazë vjetore. Si garanci për kthimin e huasë të jenë 52% te kuotave të kapitalit të shoqërisë të zotëruara repektivisht: ortaku Z.Spiro Naçi do të vendos si garanci 32% të kuotës të zotëruar në kapitalin e shoqërisë dhe ortaku Z.Valer Pinderi do të vendos si garanci 20% të kuotës të zotëruar në kapitalin e shoqërisë, pra

si garanci të jetë mostjetërsimi i 52% të kuotave të kapitalit të shoqërisë deri në kthimin e plotë të huasë së bashku me interesat brenda afatit prej 3 vitesh.

Për sa më lartë në mbështetje të Statutit të Shoqërisë, të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” Asambleja,


V E N D O S I

1. Miratimin e marrjes së huasë nga Z.Vasil Naçi, në shumën prej 250.000 Euro, me afat kthimi brenda 3 vitesh dhe me një norme interesi jo me shumë se 3% me bazë vjetore.
2. Miratimi i mostjetërsimit të 52% të kuotave të kapitalit të shoqëpër të zotëruara repektivisht nga ortakë Z.Spiro Naçi për 32% të kuotës dhe nga ortakë Z.Valer Pinderi për 20% të kuotës, si garanci për mundësimin e kthimit të huasë së bashku me interesat.
3. Vendimi i shoqërisë “Aladini Trade Partner”Sh.p.k., të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit sipas kërkesave të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe statutit të shoqërisë.

Vendimi u miratua nga ortakët e shoqërisë.

Nënshkrimi

Spiro Naçi



Valer Pinderi



Gerti Boshnjaku

